



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1191 Prot.


Rrogozhinë, më 21.03.2023

NJOFTIM

Në mbështetje të pikës 4, nenit 53 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Rrogozhinë”, njoftoj thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak e cila **do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, ditën e Hënë datë 27.03.2023 ora 14 : 00^{oo}**, me rendin e ditës si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 27.02.2023.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2023 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2023 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i Relacionit “Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.15, datë 02.03.2000 për emrin e shkollës 9- vjeçare ‘Xhorxh Soros’ “.
- 6- Miratim i projekt-vendimit , “Për miratimin në parim të servitutit të kalimit të një sipërfaqe bujqësore e ndodhur në Rrogozhinë Fshat, parcela 35/4, 35/5, 35/13 ZK 3450 dhe parcelat 272/1 dhe 274/1, ZK 3235 Bashkia Rrogozhinë”.
- 7- Miratim i projekt-vendimit, “Për disa ndryshime në VKB-në Nr.6, datë 27.01.2020 ‘Për Krijimin e komisionit për programet e strehimit social (dhënien e subvencionimit të qirasë për shkak të fatkeqësive natyrore, subvencionimin e kredisë me interesa të ulët, si dhe për dhënien e banesave sociale me qira) “.
- 8- Miratim i projekt-vendimit, “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin subvencionimi i interesave të kredisë”.
- 9- Informim i Këshillit mbi “Parandalimin e dhunës me bazë gjinore”.
- 10- Raport mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” Rrogozhinë, si dhe shqyrtim i listës së aktiviteteve të planifikuar nga ky sektor në fushën e Kulturës dhe Turizmit për vitin 2023.
- 11- Raport nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Kullimit mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe gjendja e rezervuareve në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku “12 Shtatori” Email:brrogozhine@gmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

12- Të ndryshme.

- Shqyrtim të thirrjes së kontabilistit të shoqërisë "Klub Futboll Egnatia" Sha, drejtuar aksionerëve të kësaj shoqërie.
- Shqyrtim të kërkesës për ndihmë të menjëhershme ekonomike për një familje banuese në fshatin Zhabjak, propozuar nga Administratori i Njesisë Administrative Kryevindh z. Shkelqim Gjoni.
- Shqyrtim i kërkesës së disa banorëve të lagjes Nr.1 Rrogozhinë për prerjen e disa pishave përgjatë kësaj lagjeje që mbartin pluhur dhe janë kthyer në problem për shëndetin e banorëve.
- Shqyrtim i ankesës së disa banorëve të lagjes Nr.1 Rrogozhinë për rregullimin e lagjes ku jetojnë shtrimin, kullimin, ndriçimin e saj.

Shënim : Për pikën 11 do të shqyrtohet i njëjti material i cili ju është vënë në dispozicion në mbledhjen e datës 27.02.2023, gjithashtu informacionet shtesë të kërkuara nga Këshilltarët do të relatohen ditën e mbledhjes nga drejtori i kësaj drejtorie.

Mbledhjet e Komisioneve të KB, si më poshtë :

- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 24.03.2023 ora 09 : 00 ^{oo}, Komisioni i Financës, Taksave dhe Revizionimit. Enver Memolla / Kryetar, Alime Hoxha / N/Kryetare, Haqim Tosku / Anëtar, Lulzim Hasa / Anëtar , Sheqere Biba / Anëtare.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 24.03.2023 ora 09 : 30 ^{oo}, Komisioni i Shëndetsisë, Arsimit, Rinisë, Sportit, Kulturës dhe Turizmit. Alban Sula / Kryetar, Erind Tosku N/ Kryetar, Margarita Dedej / Anëtare, Luan Sheshi / Anëtar.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 24.03.2023 ora 10 : 00 ^{oo}, Komisioni për Barazinë Gjinore dhe Përfshirjen Sociale. Margarita Dedej / Kryetare, Emiliano Aliu N/ Kryetar, Fatmira Thartori / Anëtare, Luan Sheshi / Anëtar, Anjeza Proshka / Anëtare.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 24.03.2023 ora 10 : 30 ^{oo}, Komisioni për çështjet Juridike, Rend, Konflikte. Fatjon Biba / Kryetar, Emiliano Aliu N/ Kryetar, Agim Pepa / Anëtar, Anjeza Proshka / Anëtare.
- Njoftoj të mblidhet ditën e Premte datë 24.03.2023 ora 11 : 00 ^{oo}, Komisioni i Shërbimeve Publike, Bujqësi, Blegtori dhe Pronave. Petrit Haska / Kryetar, Mejte Saliu N/ Kryetare, Haqim Tosku / Anëtar, Avni Kasa / Anëtar, Reshit Kala / Anëtar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETARE E KËSHILLIT
MUKADES GIXHARI

Adresa: Bashkia Rrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori" Email:brrogozhine@gmail.com